

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.07.2024*

**19.07.2024
Ora 14:00**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës të votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• Komisioni Rregullator:

- | | | |
|------------|-------|---------------------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar (online) |
| • Stafi | KQZ | Majlinda Çelmeta, Madalena Koja |

Parti Politike: S’ka prezent

OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme, datë 19 korrik 2024, ora 14.00. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator: katër janë të pranishëm fizikisht, kolegu Muharrem Çakaj është online, i pranishëm në mbledhjen e Komisionit. Të pranishëm janë gjithashtu: Sekretaria e Përgjithshme e KQZ-së dhe zyrtarë të tjerë të administratës dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Në mbledhjen e sotme kemi një çështje në rendin e ditës, një projektvendim “Për miratimin e disa karakteristikave

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.07.2024*

teknike të fletës të votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”. Para se të fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit do të pyesja kolegët nëse kanë çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar, kolegë? Po, zoti Çakaj?

Z. M. Çakaj: Faleminderit e nderuar Kryetare e Komisionit Rregullator! Fillimisht unë do të doja që secili nga ne, po kryesisht edhe ju, së pari të reflektonim për situatën e krijuar në mbledhjen e kaluar ku në gjykimin dhe në vlerësimin tim u shkel, veçanarisht nga ana juaj, por edhe nga përfaqësuesi i Partisë Socialiste, u shkel rregullorja që ne të pestë kemi miratuar “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Rregullator”. Së pari, mirëpres nëse ju e gjykoni të arsyeshme, e mirëpres një ndjesë. Së dyti, edhe për merakun e përfaqësuesit të Partisë Socialiste, përfaqësuesit ligjor, do ta ftoja të lexonte vendimin e Kolegjit Zgjedhor lidhur me vlerësimin e vendimmarrjes tonë, ku ka parashikuar, së pari në gjykimin dhe në vlerësimin tim, ka cituar korrekt kompetencat e Komisionit Rregullator, në nenin 20, të Kodit Zgjedhor dhe ka cituar korrekt edhe vendimmarrjen tonë për shkaqet që secili e ka vlerësuar. Vendimmarrja e Komisionit Rregullator nuk ka marrë kuorumin e nevojshëm. Pra, Kolegji Zgjedhor e njëh diskrecionin dhe vendimmarrjen e Komisionit Rregullator, gjithashtu njëh edhe kuorumin. Në këto kushte, unë përsëri, e gjej të papranueshme shantazhin dhe intimidimin që përfaqësuesi ligjor i Partisë Socialiste i bëri Komisionit Rregullator lidhur me vendimmarrjen tonë. Kështu që, nëse do ta gjykojë, do ta vlerësojë të arsyeshme, e pranojmë një ndjesë publike. Faleminderit! Kaq kisha jashtë rendit të ditës!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.07.2024*


Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Çakaj! Zonja Vukaj... Më fal zoti Çakaj, një pyetje, kjo ishte çështja jashtë rendit të ditës, nuk është se keni diçka tjetër për të diskutuar në fund, jashtë rendit të ditës, pas shqyrtimit të projektaktit?

Z. M. Çakaj: Jo, jo, kaq kisha jashtë rendit të ditës, për projektaktin do të shprehem me votën time kur të jetë diskutimi, në parim apo nen për nen.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Zonja Vukaj kërkon fjalën.

Znj. H. Vukaj: Në vijim të çfarë parashitroi kolegu Çakaj, prisja sot të gjeja prezencën në sallë të përfaqësuesit të Partisë Socialiste, i cili krijoi një precedent jashtëzakonisht të rrezikshëm për institucionet e pavaruara dhe për më tepër për atë çfarë ligji ka parashikuar, pavarësinë e shprehjes së vullnetit nga ana jonë si organe të mëvetme. Nuk është në sallë, i nderuar zoti Çakaj, përfaqësuesi dhe për këtë arsye ne nuk e marrim dot ndjesën. Ky fenomen nuk duhet të ekzistojë më! Në çdo moment që përfaqësuesi i Partisë Socialiste të paraqitet në sallë, absolutisht, duhet ta fillojë me një ndjesë publike prezencën e tij. Së dyti, do të kërkoja një ndjesë, po publike nga administrata ose përfaqësues të administratës, të cilët në referim edhe të rregullores sonë, por dhe të detyrimit që i buron si nëpunës civil, nuk e përmbushën detyrën e ngarkuar siç unë kërkoja në mbledhje, edhe pse unë kërkoja për të tretën herë dhe saktësova se çfarë kërkoja, edhe pse diskutimi im dhe kërkesa ime ishte transparente dhe e drejtëpërdrejtë për të gjitha palët prezente këtu, e për ata jashtë kësaj sale, ajo nuk u përmbush në mënyrën korrekte siç unë kërkoja. Këtë e gjej përsëri një precedent të rrezikshëm, që nuk duhet të përvijojë dhe i bëj thirrje me këtë rast administratës ose elementëve të saj, të futen urgjent në ullukun dhe drejtimin ligjor të veprimtarisë që i është ngarkuar. Pra, përgjegjësive të tyre të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.07.2024*

pozicionit. Kështu që, unë pres një ndjesë publike me qëllim që kjo situatë mos të agravohet më tej ose mos të merren masa të tjera, të cilat mund të jenë dhe në kufijtë e ndonjë vlerësimi tjetër, për gafat administrative që u servirën. Siç e dini, ju servir një institucioni të jashtëm, e gjithë korrespondenca ime e brendshme pa miratimin tim, pra të anëtarit të Komisionit Rregullator.

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Kolegë, keni diçka jashtë rendit të ditës? Jo! Nga ana e administratës zonja Çelmeta!

Znj. M. Çelmeta: Atëherë, zonja Vukaj, nëse janë bërë disa veprime që ju i gjykuat jokorrekte, janë bërë në mënyrë të paqëllimshme. Vonesa është bërë për shkak të ngarkesës së punës, megjithatë në emër të administratës, unë ju kërkoj një ndjesë të madhe publike.


Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Çelmeta! Meqenëse nuk kemi çështje të tjera jashtë rendit të ditës fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”. Zonja Çelmeta, zonja Koja, kush nga ju do të prezantojë projektin dhe relacionin?

Znj. M. Çelmeta: Do ta bëj unë.

Znj. I. Nano: Po zonja Çelmeta, faleminderit!

Znj. M. Çelmeta: Atëherë, e nderuar zonja Nano, të nderuar anëtarë të Komisionit Rregullator po filloj me relacionin për projektvendimin “Për miratimin e disa

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.07.2024*

karakteristikave teknike të fletës së votimit, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”.

Vlerësimi i ligjshmërisë dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi.

Bazuar në nenin 20, pika 1, shkronja “g”, dhe 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Rregullator ka kompetencën për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat për furnizimin dhe administrimin e materialit zgjedhor. Referuar nenit 98, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, është parashikuar kompetenca e KQZ-së për përgatitjen e fletëve të votimit, të cilat duhet të jenë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajnë elemente sigurie, sipas përcaktimeve me akt normativ të KQZ-së. Në zbatim të dispozitës së sipërcituar, administrata e KQZ-së ka hartuar projektvendimin “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”.

Përmbledhje shpjeguese e përmbajtjes së projektvendimit.

Neni 97, pika 2, e Kodit Zgjedhor përcakton se, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore zgjedhësi voton me dy fletë votimi me formë të njëjtë dhe me ngjyra të ndryshme, një për kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore dhe një për këshillin e bashkisë. Në kushtet kur zgjedhjet e pjesshme do të zhvillohen vetëm për Kryetarin e Bashkisë Himarë, edhe projektvendimi i referohet karakteristikave të fletës së votimit për Kryetarin e Bashkisë. Pika 3/1 e këtij neni përcakton se ngjyra e fletës së votimit në zgjedhjet e qeverisjes vendore është e njëjtë në të dyja anët e saj. Përveç elementeve të sigurisë së letrës, fleta e votimit do të përmbajë dhe disa elementë teknikë në formën e kodeve që identifikojnë zonën zgjedhore, qendrën e votimit si

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.07.2024*

dhe elementë të tjerë identifikues që nuk lexohen me sy të lirë (barcode). Elementët e sigurisë dhe elementët teknikë janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në lidhjen nr. 1 që i bashkëlidhet projektvendimit. Komisioni Rregullator nuk mund të shprehet në mënyrë shteruese për dimensionet e fletëve të votimit, e për këtë arsye propozohet që me këtë vendim të miratohen dimensionet minimale të tyre. Në tekstin e projektvendimit është përcaktuar se përmasat e fletës së votimit mund të ndryshohen, në varësi të subjekteve zgjedhore që do të regjistrohen në zgjedhje brenda afatit ligjor. Karakteristikat teknike të propozuara në këtë projektvendim janë të njëjta me ato të miratuara me vendimin nr. 31, datë 29.8.2023, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”. Konkretisht, propozohen karakteristikat si vijon:

- Lloji i letrës:

Letër me thurje (Watermark) jo më pak se 90gr/m² 100% pulp, me fibra karboni ultraviolet, 2 shtresa, me certifikatë origjine, me mikroprintime, elementë në printim që shikohet me rreze ultraviolet.

- Dimensionet e fletës së votimit:

Gjerësia e fletës së votimit: jo më e vogël se 210 mm

Gjatësia e fletës së votimit: jo më e vogël se 297 mm

Orientimi i fletës së votimit: Portret

- Specifikime të përgjithshme:

Stema e Republikës, me ngjyra.

Logo KQZ, me ngjyra.

- Ngjyra e fletës së votimit: kodi i ngjyrës:

PANTONE 7401 U Barkodi (elementë të fshehur teknikë në formën e kodeve).

- Numri serial: 7 shifra;

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.07.2024*

Qarku: 2 shifra;

Bashkia: 2 shifra;

Zona e administrimit zgjedhor: 2 shifra;

Numri i qendrës së votimit: 6 shifra dhe elementin ndarës “/” ndërmjet katër shifrave të para dhe dy shifrave të fundit.

- Elementë teknikë të lexueshëm në fletën e votimit:

Zona Zgjedhore;


Qendra e votimit.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vë në lëvizje Komisionin Rregullator dhe propozon për shqyrtim dhe miratim projektvendimin “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit. Së pari, kemi diskutimin në parim, kolegë? Më pas nëse ka nga shoqëria civile diskutime. Në parim, së pari e kanë fjalën anëtarët e Komisionit Rregullator, zonja Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Faleminderit! Të nderuar qytetarë, përfaqësues në sallë dhe ata që kanë interes si palë, në këtë procedim administrativ, mund të bëj një panoramë të shkurtër për një vlerësim parantezë të aktit të ardhur, i cili është një akt formalo-procedural në vazhden e aktit të nxjerrë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nr.69, datë 5.07.2024. Më pas, aktit që bëra unë si vendimmarrje e Kolegjit Zgjedhor dhe në kushtet kur ky akt i paraprin një procesi përvijues administrativ, do të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.07.2024*

ndalesha tek fakti që është një akt, i cili ka ndikim në buxhet. Kjo është paranteza, që doja të informoja publikun ose ata që kanë interes, më pas do t'ia lemë fjalën ose do të kërkoj fjalën në momentin e vlerësimit ose shqyrtimit.


Znj. I. Nano: Kolegët e tjerë lidhur me diskutimin në parim të projektaktit, padyshim sikundër zonja Vukaj e tha, ky është një akt... Zoti Çakaj, po!

Z. M. Çakaj: Faleminderit e nderuar! Atëherë, në vlerësimin dhe gjykimin tim lidhur me qëndrimin që personalisht kam mbajtur në miratimin e aktit të parë që solli Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve "Për miratimin e disa afateve procedurale". Unë vlerësoj dhe gjykoj se në këto momente ne jemi ekzaktësisht në të njëjtat kushte juridike dhe ligjore. Kjo do të thotë që vendimi numër 69 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, së pari është brenda afatit të ankimimit dhe së dyti, nuk i është nënshtruar ende, për arsye se është brenda afatit të ankimimit, verifikimit të ligjshmërisë së tij dhe sigurisht, unë personalisht kam bindjen time lidhur me natyrën e atij akti. Po kështu nuk kemi verifikimin e ligjshmërisë, pra shprehjen nga Gjykata Administrative e Shkallës Parë, lidhur me dekretin e Presidentit. Kështu që personalisht vlerësoj se ndodhemi, ekzaktësisht në të njëjtat kushte, siç ishim në aktin e parë. Kaq kisha, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Çakaj! Zonja Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Në vijim të analizës që sapo parashtroi kolegu, ndaj të njëjtin opinion, pra jemi në të njëjtat kushte, verifikimi i ligjshmërisë së aktit administrativ, individual të Komisionerit ende nuk është shteruar po kështu edhe procesi gjyqësor i ankimuar mbi dekretin ende nuk është shterues. Në këto kushte mbetemi në të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.07.2024*

njëjtat pozita, të pakonsolidimit, të vazhdimit më tej me një akt tjetër administrativ, ndaj shpreh të njëjtin qëndrim si kolegu, apo si dhe herën e parë të votuar nga ne.

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Në parim dhe unë do të doja të shprehesh lidhur me projektaktin. Sikundër ju e thatë më herët është një akt formalo-procedural dhe padyshim që dhe unë qëndrimin e kam shprehur lidhur me vazhden e miratimit të projektaktit dhe për përgatitjen e zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024. Në parim do thoja që miratimi i këtij projektvendimi i hap rrugë proceseve të tjera, që pas regjistrimit të kandidatëve nga ana e Komisionerit do të duhet të miratohet një vendim tjetër për përmbajtjen e fletës së votimit, kjo do të jetë në varësi të numrit të kandidatëve edhe të shortit që hidhet. Këto kisha unë në parim, nuk e di, kolegët nëse nuk kanë..? Po, zonja Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Në kuadër të asaj që shpreha në krye të hierës, që ky është një akt i cili i papraprin proceseve të tjera me ndikim në buxhet, personalisht vlerësoj dhe gjykoj që në rolin tim administrativ nuk mund të marr atributet ose forcën e verifikimit të ligjshmërisë të të gjithë suazës procedimore siç mund ta ketë një organ mbi palët, siç është gjykata dhe që vlerëson përfundimisht kontrollin e jashtëm të akteve. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Kolegu nga shoqëria civile, keni diçka?

Përfaqësues i KRIIK-ut: Jo, nuk kam!

Znj. I. Nano: Faleminderit! Meqënëse nuk kemi më diskutime në parim, ftoj kolegët të vijojmë me votimin në parim.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.19.07.2024*

Kush është dakord në parim me projektvendimin “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”?

Kush është dakord?

Pro: 3 (zgj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka)

Kundër: 2 (zgj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Atëherë, nuk miratohet në parim projektvendimi. Më tej nuk ka kuptim të vijojmë, nen për nen, kështu që dhe ky vendim konsiderohet i pamiratur në përmbajtjen e tij.

Meqënëse nuk kemi çështje të tjera jashtë rendit të ditës për të diskutuar, mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Faleminderit!

Vendimi nr. 03

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

